

VENDIM
Nr. 769, datë 22.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KODIN E ETIKËS DHE
PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR ANËTARËT E
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/”a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”; nenit 61, neneve 72–76 dhe nenit 97 pika 1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të Grupit të Punës për hartimin e Rregullores mbi Kodin e Etikës dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për Kodin e Etikës dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLORE

**PËR KODIN E ETIKËS DHE PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË
INTERESIT PËR ANËTARËT E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Preambulë

Të vetëdijshëm se integriteti, pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit dhe organeve të tij vetëqeverisëse përbëjnë themelin e shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike, dhe duke pasur parasysh se këto parime janë të mishëruara në Kushtetutën e Shqipërisë, si dhe në aktet ndërkombëtare pjesë e legjislacionit për gjyqësorin, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) riafirmon përgjegjësinë e tij për të mbrojtur pavarësinë gjyqësore dhe për të ruajtur besimin e publikut përmes standardeve më të larta të transparencës, llogaridhënies dhe sjelljes etike.

Duke pasur parasysh se legjitimiteti i KLGJ-së buron jo vetëm nga respektimi i ligjit, por edhe nga sjellja e anëtarëve të tij dhe duke njohur se roli i tyre në Këshill përfshin funksione qeverisëse dhe administrative, është e domosdoshme të vendoset një kuadër i përbashkët etik i zbatueshëm për të gjithë anëtarët. Ky kuadër mishëron parimet e integritetit, paanshmërisë, ndershmërisë, përkushtimit dhe eficiencës si vlera udhëheqëse në ushtrimin e mandatit të tyre.

Kjo rregullore, e frymëzuar nga kuadri ligjor kombëtar dhe standardet evropiane, synon të forcojë detyrimin e anëtarëve për të vepruar në interes publik, për të parandaluar konfliktet e interesit dhe për të garantuar paanshmërinë dhe dukjen e saj, të cilat janë të pandashme nga pavarësia dhe integriteti. Duke afirmuar këto parime, rregullorja forcon legjitimitetin e KLGJ-së dhe rrit besimin e shoqërisë tek gjyqësori në tërësi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor shpall solemnisht angazhimin e tij të palëkundur për të mbrojtur, promovuar standardet më të larta etike dhe vendos të ushtrojë veprimtarinë e tij me dinjitet, transparencë dhe përgjegjësi.

Neni 1
Parimi i pavarësisë

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor ushtrojnë kompetencat e tyre me pavarësi të plotë, të udhëhequr vetëm nga ligji. Për këtë qëllim, ata ruajnë pavarësinë nga çdo ndikim i brendshëm apo i jashtëm dhe nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga asnjë person, institucion, organ apo entitet.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të mbeten të pavarur nga çdo individ apo grup i mundshëm interesi, si nga brenda sistemit gjyqësor ashtu edhe nga jashtë tij.

3. Reagimi ndaj kritikave dhe/ose sulmeve ndaj sistemit gjyqësor dhe vetë Këshillit duhet të jetë i ekuilibruar dhe objektiv, duke synuar të shprehë saktësisht qëndrimin e institucionit, pa hyrë në gjykime të panevojshme vlerash.

Neni 2
Parimi i paanshmërisë

1. Në kryerjen e detyrave të tij, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i paanshëm dhe duket si i tillë, pa paragjykim në lidhje me interesa ose marrëdhënie personale, sociale ose politike. Në gjithë sjelljen e tyre, ai siguron që të mos lindë asnjë dyshim lidhur me paanshmërinë e tyre në ushtrimin e funksionit dhe për shkak të tij.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk veprojnë apo shprehen, në asnjë formë apo mjet komunikimi, në një mënyrë që ndikon negativisht në perceptimin publik të paanshmërisë së tyre dhe shmangin çdo situatë që mund të çojë në një konflikt interesi ose që objektivisht mund të perceptohet si e tillë, me përjashtim të mbledhjeve plenare, komisioneve dhe grupeve të punës.

Neni 3
Parimi i integritetit

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, ruajnë reputacionin, dinjitetin e institucionit dhe besimin në integritetin e tyre.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor përmbushin rolin e tyre në interesin më të mirë të sistemit gjyqësor dhe të shoqërisë, sipas parimit të integritetit, duke vepruar me ndershmëri dhe duke synuar arritjen e standardit më të lartë të sjelljes profesionale dhe personale.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor veprojnë në përputhje me detyrimin për ndershmëri dhe dinjitet, duke u përmbajtur nga çdo sjellje që bie në kundërshtim me ligjin, si dhe shmang çdo sjellje që tregon mungesë ndjeshmërie apo kujdesi gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij.

Neni 4
Parimi i bashkëpunimit dhe respektit

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në shërbim të interesit më të mirë të gjyqtarëve, sistemit gjyqësor dhe interesit publik. Kryetari i Këshillit ka rol në krijimin, ruajtjen e besimit dhe bashkëpunimin mes anëtarëve, duke siguruar që çdo anëtar të ketë qasje të barabartë në informacion dhe në vendimmarrje.

2. Aktivitete që ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm pune dhe që ndërtojnë dhe forcojnë besimin mes anëtarëve të Këshillit duhet të promovohen.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe me të tjerët në mënyrë të respektueshme, dhe të punojnë me konsideratën e duhur ndaj të tjerëve, duke synuar që vlerat e respektit dhe dëgjimit të ndahen dhe të zbatohen.

Neni 5

Parimi i respektit dhe aftësisë për të dëgjuar

1. Për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë kompetente, të pavarur dhe të paanshme, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor përftojnë, ruajnë dhe zhvillojnë njohuri dhe aftësi të rëndësishme për këto detyra, siç janë aftësia për të punuar në grup dhe aftësitë e komunikimit.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillojnë të menduarin strategjik për funksionimin sa më të mirë të sistemit gjyqësor dhe veprojnë në përputhje me rregullat ekzistuese dhe standardet e kujdesit të duhur.

Neni 6

Parimi i besnikërisë

1. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të përmbushin detyrimin e tyre për besnikëri ndaj sistemit gjyqësor dhe duhet të jenë të përkushtuar për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

2. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor i përkushtohen përmbushjes së detyrimeve të tyre ligjore. Ata duhet të sigurojnë prani të vazhdueshme në mbledhjet plenare, në komisione në të cilat janë anëtarë dhe të menaxhojnë burimet materiale të institucionit në mënyrë të përgjegjshme.

3. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor shmangin dhënien e deklaratave jashtë institucionit që mund të dëmtojnë rëndë reputacionin e tij.

Neni 7

Parimi i transparencës

1. Transparenca është e rëndësishme në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe përmirësimin e besimit të publikut. Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të veprojnë në mënyrë transparente, duke qenë në dispozicion për të dhënë arsye të vendimeve që marrin dhe duke raportuar për aktivitetet e tyre jashtë Këshillit, në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre si anëtarë të Këshillit.

2. Kur shprehet një mendim personal dhe jo institucional, është e domosdoshme të specifikohet ky fakt, duke shpjeguar arsyet e një pikëpamjeje të ndryshme ose që dallon nga ajo e institucionit që përfaqësojnë.

Neni 8

Parimi i konfidencialitetit

Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor respektojnë natyrën konfidenciale të punës së tyre kur kërkohet me ligj dhe promovojnë respektimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave personale. Detyrimi i konfidencialitetit mbetet edhe pas përfundimit të mandatit.

Neni 9

Konflikti i interesit dhe detyrimi për heqje dorë

1. Çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ushtron kujdesin e duhur për të shmangur pjesëmarrjen në një çështje ku ekziston ose ku mund të perceptohet në mënyrë të arsyeshme se ekziston një konflikt interesi, në përputhje me nenet 72–76, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe me këtë rregullore.

2. Situatat që japin shkas për konflikt interesi përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në papajtueshmërinë për shkak të pjesëmarrjes në procedim, papajtueshmërinë për shkak të

lidhjeve familjare, gjinie ose krushqie, si dhe rastet e heqjes dorë të anëtarëve të Këshillit, si lidhje financiare, juridike ose profesionale ndërmjet anëtarit (ose të afërmeve të tij të ngushtë) dhe subjektit të procedurës.

3. Anëtari që identifikon një konflikt personal interesi është i detyruar ta deklarojë menjëherë dhe të mos marrë pjesë më tej në diskutim ose votim për çështjen. Në rast se anëtari s'është i sigurt nëse rrethanat përbëjnë konflikt interesi, ai/ajo mund të paraqesë kërkesë për heqje dorë, deri në marrjen e vendimit nga kryetari i Këshillit, zëvendëskryetari ose mbledhja plenare, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4. Kërkesa për deklarimin e konfliktit të interesit ose kërkesës për heqje dorë duhet të paraqitet pa vonesë dhe, në çdo rast, para fillimit të diskutimeve mbi çështjen. Deri në marrjen e vendimit, anëtari subjekt i kërkesës për përjashtim nuk merr pjesë në procedurë.

Neni 10

Përjashtimi i një anëtari nga procedimet për shkak të konfliktit të interesit

1. Një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të përjashtohet nga një procedim për shkak të konfliktit të interesit:

- a) me kërkesë të vetë anëtarit të interesuar (kërkesë për heqje dorë);
- b) me kërkesë të paraqitur nga një anëtar tjetër i Këshillit;
- c) me kërkesë të paraqitur nga gjyqtari, funksionari publik ose pala e përfshirë në çështje.

2. Kërkesat për përjashtimin e një anëtari duhet të paraqiten pa vonesë dhe, në çdo rast, para fillimit të diskutimeve thelbësore mbi çështjen. Deri në marrjen e vendimit, anëtari subjekt i kërkesës për përjashtim nuk merr pjesë në procedurë.

3. Në rastet kur kryetari ose zëvendëskryetari i Këshillit paraqesin kërkesë për heqje dorë për shkak të konfliktit të interesit lidhur me marrëdhëniet familjare, farefisnore ose martesore, kërkesa shqyrtohet respektivisht nga zëvendëskryetari ose kryetari i Këshillit.

4. Nëse kërkesa lidhet me një konflikt të mundshëm interesi sipas neneve 72 ose 75 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, vendimin për përjashtimin e anëtarit e merr mbledhja plenare, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, pa pjesëmarrjen e anëtarit subjekt i vendimarrjes.

5. Anëtarit subjekt i kërkesës dhe i vendimarrjes, i jepet mundësia të paraqesë qëndrimin e tij/saj para se të merret vendimi.

6. Nëse mbledhja plenare vendos për përjashtimin e anëtarit, Këshilli vijon procedimin pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar, dhe vendimi për përjashtim pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes. Nëse mbledhja plenare nuk pranon kërkesën për përjashtim, anëtari vijon të marrë pjesë në procedim dhe nuk përjashtohet. Vendimi bëhet pjesë e dosjes ose raportit përfundimtar të çështjes.

7. Në çdo rast, nëse mbledhja plenare konstaton se një anëtar me dashje nuk e ka deklaruar konfliktin e interesit dhe më pas vendos për përjashtimin e tij/saj, Këshilli ia referon çështjen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shqyrtim të mëtejshëm, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 11

Zbatimi

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një komisioni për etikën për të evidentuar në kohën e duhur çështje etike dhe shkelje të mundshme. Komisioni duhet të zhvillojë konsultime mbi çështjet etike dhe të angazhohet në aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit mbi standardet etike.

2. Duhet të merret, gjithashtu, në konsideratë vendosja e një procedure që t'i japë mundësi çdo anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor të sjellë në vëmendjen e komisionit dhe/ose të mbledhjes plenare çështje problematike që lidhen me zbatimin e rregullores.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.